REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA LUSHNJE

KRYETARI

Nr 2763 Prot Lushnje 30 / 03 /2023

VENDIM

Nr.205 Datë 30/03/2023

"PËR PËRDORIMIN DHE AFISHIMIN E ÇDO MATERIALI PËR PROPAGANDË ZGJEDHORE "

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe ligjin nr 118/2020 datë 05.10.2020) (i përditësuar, 2020) neni 79 pika 2, Udhëzim nr. 6, date 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

V E N D O S :

1. Afishimi i çdo materiali tjetër statik për propogandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohen vetëm në një largësi prej 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjekti zgjedhor përkatës.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
3. Ndalohet vendosja e materialeve propagandastike në mjete që operojnë në transportin publik.
4. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Policia Bashkiake.

KRYETAR I BASHKISË
ERISELDA SEFA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com